

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel akademik pranë Institutit të Gjeoshkencave si më poshtë:

A. 1 (një) vend pune për personel akademik në Departamentin e Meteorologjisë, në Institutin e Gjeoshkencave duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

I. Kualifikimi arsimor:

- Të ketë përfunduar studimet e larta në Meteorologji, Shkenca Atmosferike dhe Inxhinieri Mjedisi.
- Të ketë gradën shkencore “Doktor” në fushën e Meteorologjisë.
- Nota mesatare e studimeve universitare Bachelor dhe Master i Shkencave të jetë i barabartë ose më i lartë se 8 (tetë).

II. Përvoja profesionale:

- Minimumi 5 vite përvojë profesionale dhe akademike në:
 - Parashikim dhe monotorim të rreziqeve natyrore
 - Shërbime meteorologjike dhe klimatike
 - Eksperiencë në përpunimin dhe analizën e të dhënave meteorologjike dhe klimatike
 - Aftësi në hartimin e raporteve teknike dhe dokumenteve strategjike
- Përvojë në institucione publike ose projekte ndërkombëtare
- Të ketë specializime/ certifikime në:
 - Skenarë ose projeksione klimatike (CMIP6/AR6)
 - Sistemet e Paralajmërimit të Hershëm (EUMETSAT, EFAS, CAP, etj)
 - Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë (ISO 9001 në shërbimet klimatike).

III. Aftësi organizative dhe komunikimi:

- Aftësi shumë të mira prezantuese dhe komunikimi publik.
- Aftësi për koordinim ndërinstytucional.
- Përvojë në trajnime ose “Training of trainers”.
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze (minimum C1), gjuhë të tjera përbëjnë avantazh.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;

4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **08.05.2026** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.